



Datë: 13.08.2025
Numër Protokolli: 5485/2025

A.nr.785/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.785/2025 të datës 30.04.2025 të parashtruar nga ankuesi F.A, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Hajzer Salihu nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*transferim si rezultat i rristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.08.2025 mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.785/2025 e datës 30.04.2025 e parashtruar nga ankuesi F.A.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, F.A (*tani e tutje referuar: ankuesi*), me datë 30.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit MMPHI-298/2025, të datës 18.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministra e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje MMPHI), ndërsa kjo e fundit më datë 11.07.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.785/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit, sipas Aktit të Emërimit të datës 05.01.2015 është e punësuar në pozitën *Zyrtar për Rindërtim*, në MMPHI.

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se sipas Vendimit me Nr.073/2024 të datës 29.03.2024 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me ç'rast procesi i organizmit të MMPHI, është pasuar me shuarje të pozitive, ndryshime në emërtime të pozitive përkatëse si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kritereve të punës për pozita të caktuara.

Rrjedhimisht, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin me Nr.2392/2024, të datës 29.11.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrinë e Shëndetësisë, ku ky i fundit më datë 03.03.2025 ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në MMPHI, përmes të cilit ankuesin e ka propozuar të transferohet në pozitën Zyrtar Administrativ në Divizionin për Planifikim Hapësinor. Bazuar në këtë raport, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB, më datë 18.03.2025 ka nxjerr Vendim MMPHI-298/2025, me të cilin ankuesin nga pozita Zyrtar për Rindërtim e ka transferuar në pozitën Zyrtar Administrativ.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit MMPHI-298/2025, të datës 18.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB, pretendon se i njëjti është përcjellë me shkelje të dispozitave të ligjit për zyrtarët publik, duke kërkuar që i njëjti të sistemohet në një pozitë në Divizionin për Ndërtim dhe Trajnimin e Ndërtimeve pa leje.

Duke qenë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kishte pranuar disa ankesa të nëpunësve civilë të pakënaqur më procesin e ristrukturimit në MMPHI, Këshilli më Vendimin me numër A.nr.786/2025, të datës 11.08.2025, ka aprovuar ankesën e datës 30.04.2025, të parashtruar nga të ankuesi Besim Tahiri, duke shfuqizuar Raportin Përfundimtar të Komisionit të Ristrukturimit në MMPHI të datës 03.03.2025 dhe të gjitha vendimet dhe procedurat që rrjedhin nga ky raport.

Referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.785/2025, të datës 30.04.2025, ka të bëjë më vendimin për transferim për shkak të ristrukturimit, vendim ky, i pasuar si veprim nga zbatimi i Raportit Përfundimtar të Komisionit të Ristrukturimit në MMPHI të datës 03.03.2025, e duke qenë se ky akt është shfuqizuar si i paligjshëm me Vendimin A.nr.786/2025, të datës 11.08.2025 të KPMSHCK-së, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”. Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.785/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.785/2025, të datës 30.04.2025.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, me numër A.nr.785/2025.

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Hajzer Salihu;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MMPHI;*
- *Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, si dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*